



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BELSH

Belsh më: 15 . 09.2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: *Blerje shërbimi hartim projekti “ Ndertimi i ambjenteve per zyra te Bashkisë Belsh ”.*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Projekte

VLERA E FONDIT LIMIT: **1 663 766( nje milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e tre mijë e shtateqind e gjashtedhjetë e gjashtë ) leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Belsh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2020-2021-2022**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".*

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Duke marre ne konsiderate vleren e fondit limit te kesaj procedure prokurimi, kërkohet qe OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për ketë, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit lotit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4, "Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet 40 % të vlerës

së përlllogaritur të kontratës/lotit, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatimit Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, germa “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Shënim:** Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, germa “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.*

**2.2.2** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me

legjislacionin ne fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

**Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d),neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

*Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore per vitin 2021 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për funizime te mëparshme të ngjashme, në një vlerë **jo më të vogël se 20% të** vlerës së përlloragitur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës

b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të **plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore,** ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ”Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlloragitur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

*Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë, Liçences profesionale për shoqërinë, sipas VKM nr. 943, date 28.12.2016, lidhja 2, e vlefshme për kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim lëshuar nga MIE dhe/ ose MZHU dhe/ose nga cdo Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, për këto kategori:

**Kat. 2. PROJEKTUES ARKITEKT**

- a-Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike
- c-projektim interiere
- d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelberta, lulishte e parqe.

**Kat. 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

- a- Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

**Kat. 4. PROJEKTUES INSTALATOR**

- a-Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;
- b-Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- c-Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;
- d- Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit
- e-projektim të sistemeve të funizimit me gaz.
- f-projektim të sistemeve kundër zjarrit .
- h- projektim i impianteve ngritëse e transportuese(ashensor, shkallë levizëse)
- j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale.

**Kat. 8. PROJEKTUES GJEODET**

- a. Rilevime inxhinierike
- b. Rilevime inxhinierike kadastrale

**Kat. 9. STUDIMGJEOLIGO-INXHINERIK-HIDROGJEOLOGJIK**

- a-studim/vlerësim gjeologjicoinxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri në 5kate.

**Kat.12.STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE(VETEM PËR SHOQËRI /PERSONA JURIDIK)**

- b-studime /vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale kulturore.

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licencat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
2 – a	Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike	Bazuar në termat e referencës, objektet qe do ndertohet do jene ambjetente per zyra per te cilat do te nevojiten planet, fasadat dhe detajet arkitektonike ku do te kete nderhyrje, si rrjedhojë, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
2-c	projektim interiere	Bazuar në termat e referencës, objekti qe do ndertohet do jene ambjetente per zyra per te cilat do te nevojiten planet dhe dizeno per zyrat.
2-d	Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe te gjelberta, lulishte e parqe	Bazuar në termat e referencës, objekti qe do te ndertohet do te kete sipërfaqe te gjelberta dhe lulishte .
3 – a	Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	Bazuar në termat e referencës, zyrat/godina jane kryesisht deri ne 5 kate me structure murature dhe beton arme, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
4-a	Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;	Bazuar në termat e referencës,gjate ekspertizes dhe vleresimit per realizimin e projektit per riaftesimin strukturor mund te lind e nevojshme vleresimi I ndikimit dhe nderhyrja ne sistemet hidraulike te cilat duhet te rikthehen ne gjendjen e meparshme, kete vleresim dhe roject duhet ta realizoje inxhinieri hidroteknik me kategorine perkatese te kerkua si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për

		realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>4-b</b>	Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.	Bazuar në termat e referencës, gjatë ekspertizës dhe vlerësimit për realizimin e projektit për rrafshimin strukturor mund të lindë e nevojshme vlerësimi I ndikimit dhe nderhyrja në sistemet termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme
<b>4-c</b>	Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile të industriale;	Bazuar në termat e referencës, gjatë ekspertizës dhe vlerësimit për realizimin e projektit për rrafshimin strukturor mund të lindë e nevojshme vlerësimi I ndikimit dhe nderhyrja në sistemet elektrike të cilat duhet të rikthehen në gjendjen e mëparshme, këtë vlerësim dhe projekt duhet ta realizojë inxhinieri hidroteknik me kategorinë përkatëse të kërkuar, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>4-d</b>	Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit	Bazuar në termat e referencës, gjatë ekspertizës dhe vlerësimit për realizimin e projektit për rrafshimin strukturor mund të lindë e nevojshme vlerësimi krijimi I rrjetit të sistemeve komplekse të telekomunikacionit, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>4-e</b>	projektim të sistemeve të funizimit me gaz.	Bazuar në termat e referencës, gjatë ekspertizës dhe vlerësimit për realizimin e projektit për rrafshimin strukturor mund të lindë e nevojshme vlerësimi I ndikimit dhe nderhyrja në sistemet e funizimit me gaz, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>4-f</b>	Projektim të sistemeve kundër zjarrit.;	Bazuar në termat e referencës, gjatë ekspertizës dhe vlerësimit për realizimin e projektit për rrafshimin strukturor mund të lindë e nevojshme vlerësimi I ndikimit dhe nderhyrja në sistemet MKZ të cilat duhet të rikthehen në gjendjen e mëparshme, këtë vlerësim dhe projekt duhet ta realizojë inxhinieri me kategorinë përkatëse të kërkuar, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>4-h</b>	projektim i impianteve ngritëse të transportues (ashensor, shkallë levizëse)	Bazuar në termat e referencës, gjatë ekspertizës dhe vlerësimit për realizimin e projektit për rrafshimin strukturor mund të lindë e nevojshme vlerësimi I ndikimit dhe nderhyrja në impiantet e ngritëse transportuese, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>4-j</b>	Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për	Bazuar në termat e referencës, gjatë ekspertizës dhe vlerësimit për realizimin e projektit për rrafshimin strukturor mund të lindë e nevojshme vlerësimi I ndikimit dhe nderhyrja në rrjetin e telefonisë, fonisë, internetit, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

	objektet civile dhe industriale.	
<b>8 – a</b>	Rilevime inxhinierike	Bazuar në termat e referencës, realizimi I ekspertizes se thelluar do te konsistojne ne rilevimin e objektit subject I ekspertizes, si dhe matjet e devijimit vertical te elementeve strukturor nga goditjet sizmike apo difektet e realizimit te cilat ndikojne drejtperdrejte ne efektin sizmik, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>8-b</b>	Rivelime inxhinierike kadastrale	Bazuar në termat e referencës, per realizimin e Ekspertizave te thelluara nevojitet infirmacion per karakteristikat kadastrale te truallit ku ndodhet objekti me qellim rimodelimin e strukturave, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>9 – a</b>	Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.	Bazuar në termat e referencës, per realizimin e Ekspertizave te thelluara nevojitet infirmacion per karakteristikat gjeologjike te truallit ku ndodhet objekti me qellim rimodelimin e strukturave, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>12 – b</b>	studime /vleresime gjeologo-sizmike per trojet ku ndertohen objektet civile, sociale e kulturore.	Bazuar në termat e referencës, per realizimin e Ekspertizave te thelluara nevojitet infirmacion per karakteristikat gjeologo-sizmike te truallit ku ndodhet objekti me qellim rimodelimin e strukturave, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

**2.3.3** Një punësim mesatar të paktën **10 ( dhjete )** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen Mars-Gusht2023;

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e fundit te deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

**Shënim:** *Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se



jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri I mesiper perkon me stafin qe pritet te jete I angazhuar ne keto procedura.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik te perfshire ne Licensen e Shoqerise stafin si më poshtë, vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome, Licence profesionale individuale dhe te jenë te perfshirë ne Listpagesën e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore dhe TAP, te shoqërisë sipas formularit e-sig për muajin Mars- Gusht 2023 te deklaruar:

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1(nje) Inxhinier Ndertimi ;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier gjeodet;
- 1 (nje) Inxhinier gjeolog;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeofizik/Sizmolog;
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi;

**Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,**, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Punimet per sherbimin e projekteve strukture kane gjithashtu nje volum te rendesishem, pasi kryesisht parashikohet te kemi realizim te objekteve me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i profilit Strukturist do te duhet dhe ne projektimin e nderhyrjeve te reja si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) inxhinier ndertimi** , pjese e stafit teknik.
- Sherbimet per projektimin arkitektonik priten te kene nje volumin te moderuar te projekteve qe realizohen per nivelin e objekteve dhe realizimit te peizazhit subjekt i kesaj procedure, si objekte te nje kategorie te vecante per te cilen gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) Arkitekti** si staf teknik (arkitekthe godinash, peisazhi, etj).

- Punimet per studimin dhe vleresimin gjeologjik do te jene te pranishme kryesisht ne vleresimin gjeologjik per vlersimin, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje inxhinieri gjeolog** si staf teknik.
- Punimet per sherbimin e projektimit topografik do te jene nje ze i rendesishem ne realizimin e projekteve qe parashikohen te kene dhe volume te konsiderueshme te punimeve topografike si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) gjeodet** si pjese e stafit teknik.
- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve elektrike parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri elektrik**, si pjese e stafit teknik.
- Punimet per sherbimet e projektimit te sistemeve mekanike do te jene dhe pasqyrohen me ane te sistemeve te projektimit te portave, sistemeve mekanike te sinjalistikes ndricuese dhe jondricuese per infrastrukturen etj, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri mekanik**, si pjese e stafit ndihmes.
- Drejtues Teknik Inxhinier Mjedisi – kerkohet per masat mbrojtese ne mjedis si dhe per hartimin e projekti te siperfaqeve te gjelberta
- Drejtues Teknik Inxhinier Gjeofizik/Sizmolog- kerkohet per realizimin e Ekspertizave te thelluara nevojitet informacion per karakteristikat gjeologo-sizmike te truallit ku ndodhet objekti me qellim rimodelimin e strukturave.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet te kete stafit ndihmes si me poshte , vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome, Licence profesionale individuale dhe te jenë te perfshirë ne Listpagesën e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore dhe TAP, te shoqërisë sipas formularit e-sig për periudhen Mars-Gusht 2023 te deklaruar:

- 1 (nje) preventivues
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

*Kriteri për stafin ndihmes, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për stafin ndihmes në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për sherbimin e mbikqyrjes se punimeve te zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të sherbimit. Numri i stafit ndihmes është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën*

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e shoqerise personel te kualifikuar/certifikuasi:

- 1(një) Auditues Energjitik I certifikuar nga Agjencia per Eficencën e Energjisë për të kryer auditime ne ndërtesë, shoqëruar me kontratë individuale pune te vlefshme,diplomë/certifikatë, CV di dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periushen Mars -Gusht2023.
- 1(një) punonjës të pajisur me certifikatë si "Ekspert Privat Zjarrëfikës” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, CV, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars -Gusht 2023.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

*Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull teknik lidhur me kantier. 1 (nje) ekspert zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, Auditues Energjitik i Certifikuar nëpërmjet dijës dhe eksperiencës të fituar në këtë fushat perkatese, duhet te kontrollojn cdo punim ndertimor, te parndalojn cdo avari që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë vazhdimetin e punimeve gjate zbatimit . Në këto kushte, vendosja e këtyre kriterëve shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë procesin e mbikqyrjes se punimeve sipas standarteve ligjore në fuqi.*

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe Pajisjet Gjeodezike si më poshtë:

-1(një) Pajisje GPS

-1(një) Pajisje Total Station V

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronesisë së qiradhënësit original ose fotokopje e noterizuar).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet topografike e asete të tjera fizike, aftësitë organizative etj. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. *Pajisje e mësipërm është e nevojshme për të realizuar matjet në vend dhe nxjerrjen e të dhënave gjatë dhe për hartimit të projektit.* Paisje GPS është kërkuar pasi është i domosdoshëm për procesin e rilevimit të bllokut të banimit, Paisje Total Station, është kërkuar pasi është i nevojshëm sidomos për projektet e rrugëve, hartimin e profilave tërthorë e gjatësorë.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës , duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta janë hartuar në varësi të objektit të kontratës përcjellë me shkresën nr.- 2438prot., datë 15.09.2023 nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit.**

*Specifikimet teknike, të hartuara për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë elementet më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, dhe çdo standard të kërkuar, referuar kërkesave dhe standarteve ndërkombëtare për automjetet.*

**Njesia e prokurimit publik:**